

**YOU
BED**



NJOFTIMI PËR SHTYP
15 shtator 2020

Risia suedeze revolucionarizon industrinë globale të hoteleve

Prioriteti i parë për çdo hotel duhet të jetë ofrimi i një gjumi të mirë gjatë natës për mysafirët e tij. Ky shërbim, gjithsesi duhet të përfshijë garancinë e një shtrati komod hoteli; një premtim që, deri më tani, ka qenë i pamundur të mbahet duke qenë se të gjithë mysafirët kanë preferencat e tyre unike. Kjo mund të ndryshojë tani që kompania suedeze YouBed prezanton një risi në shtrat duke siguruar rehati të personalizuar të dyshekëve. Së bashku me Business Sweden, Këshillin Suedez të Tregtisë dhe Investimeve, YouBed aktualisht po bën një prezantim global, duke e përcjellë risinë e tij për një shtrat të përshtatshëm për të gjithë, në mbarë rrejetet e hoteleve kudo në botë.



Kompania suedeze YouBed ka shpikur një mënyrë për të rregulluar fortësinë në një dyshek të cilësisë së lartë me susta në xhepa, pa kompromentuar nivelet më të larta të komoditetit të gjumit, thjesht me anë të përdorimit të një telekomande. Kjo zgjidhje me një shtrat të përshtatshëm për të gjithë do të jetë e disponueshme globalisht përmes një koncepti unik të gjumit që mendohet se po revolucionarizon sistemin e sektorit të hotelerisë, duke bërë të mundur që hotelet të ofrojnë më në fund atë që meriton çdo mysafir: garancinë e një shtrati komod hoteli dhe kushtet më të mira për një gjumë ideal gjatë natës.

- Komoditeti i personalizuar i gjumit është hallka e munguar, e cila do t'u mundësojë përfundimisht hoteleve të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Shpresojmë që shumë do ta shohin këtë si një mundësi të shkëlqyeshme për të përmirësuar ofertën dhe aftësinë konkurruese të hotelit të tyre.

Unë nuk do të befasohesha nëse risia jonë krijon një model zhvendosjeje brenda sektorit të hotelerisë dhe është përgjegjësia jonë të mbështesim këtë zhvillim në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë arsye kemi kaluar vite duke provuar konceptin e gjumit, duke krijuar gjithashtu infrastrukturën dhe kapacitetin për

të mbështetur një kërkesë të prishme globale, thotë Mattias Sörensen, Drejtor i Përgjithshëm dhe themelues i YouBed.

Koncepti i gjumit të YouBed tashmë po prezantohet në nivel global në një bashkëpunim unik me Business Sweden dhe departamente të tjera qeveritare. 44 zyra të reja të YouBed - me aftësinë për të mbështetur çdo treg të botës - tashmë kanë nisur komunikimin me grupet rajonale të hoteleve që pritet të drejtojnë prezantime lokale në të gjithë botën.

-Që herët, YouBed vendosi të përdorë strukturat tona ekzistuese të mbështetjes, një rrugë e shkurtër që kompanitë lider e përdorin për të hyrë shpejt në tregjet globale. Duke qenë se u përfshimë që në fillim të procesit, ne mund të përshtatnim angazhimin tonë bazuar në këtë marrëdhënie afatgjatë biznesi. Ne ndihemi vërtet krenarë që jemi pjesë e krijimit të një kompanie të re shumëkombëshe suedeze dhe që mbështesim inovacionin e tyre revolucionar në cilësinë që meriton, shprehet Fredrik Fexe, Zëvendës President Ekzekutiv, Shef i Strategjisë dhe Zhvillimit të Biznesit në Business Sweden.

YouBed është aktualisht i disponueshëm në të gjitha hotelet Mövenpick Hotel në Evropë, si dhe në ato Scandinavian First Hotel dhe Scandic Hotels. Koncepti i gjumit YouBed është fillimisht i disponueshëm vetëm për prezantimet e markave të korporatave që përfshijnë çdo hotel brenda rrjetit. www.youbed.com

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

Znj. Ulrika Hallström, Menaxher Zyre në Zyrën e YouBed Austria, Balkans & Israel,
AustriaBalkanIsrael@youbedglobal.com, telefon: +43 800 784702

Rreth YouBed

Kompania suedeze YouBed ka shpikur dhe patentuar një mënyrë të re për rregullimin e fortësisë së një dysheku me susta të cilësisë të lartë në xhepa. Rregullimi realizohet shpejt dhe me lehtësi me ndihmën e një telekomande, dhe pa kompromentuar nivelet më të larta të rehatisë së gjumit dhe shtratit. Ju gjithashtu mund të rregulloni pjesë të ndryshme të dyshekut në mënyrë të pavarur (në pjesën e shpatullave dhe vitheve) për të mundësuar komoditet optimal të gjumit për të gjithë përdoruesit, pavarësisht nga lartësia, pesha, forma e trupit ose pozicioni i preferuar i gjumit. Rezultati është shtrati i parë i personalizuar në botë që garanton komoditet, duke shpalosur mundësi të mëdha dhe krijimin e vlerës në sektorët ku gjumi dhe shtretërit luajnë rol primar.

Rreth Business Sweden, Këshillit Suedez të Tregtisë dhe Investimeve

Business Sweden, Këshilli Suedez i Tregtisë dhe Investimeve, ndihmon kompanitë suedeze të rrisin shitjet e tyre globale si dhe kompanitë ndërkombëtare të investojnë dhe zgjerojnë biznesin e tyre në Suedi. Business Sweden ndihmon kompanitë suedeze duke shkurtuar kohën në treg, duke gjetur burime të reja të ardhurash dhe duke ulur nivelin e riskut. Gjithashtu ndihmojnë edhe kompanitë ndërkombëtare që të gjejnë mundësi të reja biznesi, duke rritur kthimin e kapitalit dhe duke ofruar një mbështetje të paanshme. Me rrjete në të gjitha nivelet, ato ofrojnë këshilla strategjike dhe mbështetje të prekshme në 44 nga tregjet më interesante në botë. Business Sweden është në pronësi të përbashkët të shtetit dhe komunitetit të biznesit.

**YOU
BED**



Rreth kompanisë

Krijuar:	2012
Të ardhurat/Rezultati:	Nuk ka shitje që nga periudha e demonstrimit të konceptit që përfundoi në vitin 2018 për të optimizuar kushtet për prezantimin global.
Bordi i drejtorëve:	Mattias Sörensen, Drejtor Ekzekutiv dhe themelues Stefan Hyltenfeldt; Drejtor Teknik dhe themelues Lars Björklund; Shefi i Pronësisë Intelektuale dhe ish-president në Agjencinë e Patentave Suedeze Olle Bergström: Zyra Globale e Menaxhimit të Programit dhe Operacionet në Telia
Numri i zyrave:	44
Personeli dhe organizimi:	Rreth 250 (duke përfshirë konsulentët), nga të cilët 14 janë të vendosur në Zyrën Qendrore në Stokholm dhe pjesa tjetër në 44 zyra rajonale në të gjithë botën.
Tregjet:	Globale
Numri i pronarëve:	109
Kapitali i ngritur:	6 milionë EUR

Inovacioni

- Kompania suedeze YouBed ka shpikur dhe patentuar një mënyrë të re për rregullimin e fortësisë së një dysheku të cilësisë së lartë me susta në xhepa, duke ruajtur njëkohësisht edhe nivelet më të larta të komoditetit të gjumit gjatë gjithë kohës.
- Është e mundur të rregullohet lehtësisht dysheku në tërësinë e vet apo pjesë të ndryshme të tij në mënyrë të pavarur për të arritur një personalizim të përsosur. Rregullimi realizohet me lehtësi përmes një telekomande që e kontrollon dyshekun në tërësinë e vet.
- YouBed i rregullueshëm bazohet në teknologjinë më të fundit të kornizës së shtratit, që lejon që shtresat e dyfishta të sustave në xhepa të funksionojnë në mënyrë të pavarur në të gjithë gjatësinë e vet, për të absorbuar në mënyrë optimale peshën dhe formën e trupit të përdoruesit.
- Sistemi i sustave në xhepa mund të ngjishet ose të hapet lehtësisht me anë të përdorimit të telekomandës, duke e bërë dyshekun më të fortë ose më të butë dhe duke ruajtur në të njëjtën kohë plotësisht nivelet më të larta të komoditetit në shtrat. Ju gjithashtu mund të përshtatni zona të ndryshme të komoditetit të shtratit, shpatullave dhe vitheve, për të arritur një personalizim absolutisht të përsosur.
- Telekomanda do të shfaqë në çdo moment kombinimin e saktë të fortësisë, duke i mundësuar secilit përdorues profilin e vet unik të komoditetit për përdorim të mëvonshëm.
- Pavarësisht nga lartësia, pesha, forma trupore ose pozicioni i preferuar i gjumit, një YouBed do të plotësojë nevojat individuale të çdo përdoruesi unik.



Proof of concept

Based on more than 2 000 sold YouBeds, we have been able to analyze and measure the exact effect of replacing a normal static bed with a personalized YouBed. The results from various studies are extremely positive, although not that surprising, as they demonstrate the effect of commercializing the industry's core business for the first time.

- A large NPS study showed that the number of Promoters (the highest level of customer satisfaction) increased by a remarkable 14%¹ when a regular bed is replaced by a YouBed (where normally 3-5% is considered a success in regard to increased customer satisfaction).
- Customer loyalty increased dramatically. More than 80% who slept in a YouBed room say they will choose the same room category on the next visit, compared to well below 20% for other room categories.
- The willingness to pay a premium increased and the average room rate rose by 20 Euros² per sold night.
- Room and hotel occupancy increased significantly as a result of its strong ability to attract new guests to the hotel.
- The pay-back period for a YouBed investment is between 3 to 6 months, which means that the investment is repaid 2 to 4 times every year during the life span of the product (16–32 times after 8 years).
- Every hotel chain will be invited to try out and evaluate the concept and its effects before a decision of purchase is made.



¹ <https://www.loopon.com/blog/adjustable-beds-study>

² Mesatarja nga studime të ndryshme për të ardhurat dhe kënaqësinë e klientit në demonstrimin e konceptit tonë për partnerët: Mövenpick Hotel & Resorts, First Hotels dhe Scandic Hotels.